



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 202200840/7**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2022

**Lënda :**            *Rekomandim për nxjerrjen e një udhëzimi drejtuar organeve të prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm për ndryshimin e praktikës së deritanishme në zbatim të Raportit të CTP-së (2019) për ndarjen e procedimeve penale dhe hetimin e tyre nga prokurorë të ndryshëm në rastet e kallëzimeve/ankesave për keqtrajtim të shtetasve nga punonjësit e policisë, si dhe për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me respektimin e të drejtave të kallëzuesit dhe viktimës.*

**PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**  
**Z. Olsian Çela**

**Tiranë**

*I nderuar Z. Çela,*

Institucioni i Avokatit të Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm ka marrë në shqyrtim ankesa nga shtetas të ndryshëm, të cilët kanë paraqitur pretendime ndaj organeve të prokurorisë dhe kryesisht të Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para për disa problematika që lidhen me veprimtarinë e këtyre organeve. Më konkretisht, shqetësimet e ngritura prej tyre, po i parashtrijmë si më poshtë vijon:

**1.** Ka pasur disa raste për të cilat nga organet e prokurorisë janë filluar procedimet penale ndaj shtetasve për kryerjen e veprave penale të ndryshme. Ndërkohë nga ana e këtyre personave ndaj të cilëve zhvillohen hetime janë bërë kallëzime apo ankesa gjatë seancave

gjqësore për vleftësimin dhe caktimin e masave të sigurimit personal, për dhunim fizik të tyre nga punonjësit e Policisë së Shtetit gjatë momentit të kapjes, shoqërimit në organet e policisë apo gjatë marrjes së deklarimeve të tyre. Nga organet kompetente të prokurorisë janë administruar kallëzimet e bëra nga personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime apo prokurorët e çështjes kanë filluar kryesisht procedimin penal në rastet e ankesave të paraqitura në seancat gjyqësore nga të dëmtuarit. Por, në vijim të veprimeve, konstatohet se procedimet penale janë bashkuar në të njëjtin procedim dhe hetimet janë ndjekur nga i njëjti prokuror.

Kjo problematikë është trajtuar nga ana jone dhe është bërë objekt i disa rekomandimeve të cilat u janë dërguar organeve respektive të prokurorisë. Pavarësisht adresimit, evidentojmë se ky qëndrim është i përsëritur. Ndaj, vlerësojmë se duhet sjellë në vëmendjen tuaj standardi ndërkombëtar më i mirë në qëndrimin e organit të prokurorisë për të garantuar të drejtat e shtetasve të pandehur gjatë procesit penal.

Lidhur me bashkimin e procedimeve penale kur kemi kallëzime të ndërsjellta të palëve konkretisht ndërmjet të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Policisë së Burgjeve apo të Policisë Bashkiake dhe shtetasve nën hetim, evidentojmë gjetjet e Raportit të CPT-së i bërë publik në datën 17.09.2019, pas vizitave që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 nëntor 2018. Për lehtësi trajtimi po ju informojmë se në pjesën e raportit që ka të bëjë për Policinë e Shtetit dhe prokurorinë përshkruhen konstatimet dhe rekomandimet për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar dhe konkretisht:

#### *A. Ndalimi nga Policia*

##### *2. Keqtrajtimi*

*14. Është thelbësore të sigurohet që punonjësit e policisë në të gjitha nivelet të jenë të vetëdijshëm se qeveria është e vendosur të pengojë keqtrajtimin e personave të privuar nga liria duke forcuar përgjegjshmërinë e policisë dhe duke hetuar në mënyrë efektive pretendimet për keqtrajtim.*

*CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimin nga punonjës të policisë. Në veçanti, duhet t'u silltet në vëmendje punonjësve të policisë se të gjitha format e keqtrajtitimit (përfshirë dhunën verbale) janë të paligjshme dhe do të dënohen në përputhje me rrethanat.*

*Oficerët e policisë gjithashtu duhet të trajnohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është nevojshme kur kapin një person dhe pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme.*

*15. Përbërës thelbësor i çdo strategjie për të parandaluar keqtrajtimin është shqyrtimi i kujdesshëm nga autoritetet kompetente i të gjitha ankesave për keqtrajtim dhe dhënia e një dënimi të përshtatshëm. Nëse nuk ka reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj një të dhëne për keqtrajtim, personat e cënuar shpejt do të besojnë se këto shkelje nuk*

ndëshkohen. Në mënyrë që hetimi mbi keqtrajtimin e mundshëm të policisë të jetë efektiv, procedura duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Hetime të tilla duhet të përputhen ndër të tjera me kriterin e shpejtësisë, tërësisë dhe gjithëpërfshirjes.

16. Nga konsultimet që delegacioni zhvilloi me prokurorin e rrethit përgjegjës për rastet e keqtrajtimin të referuar nga IEVP 313, është vënë në dijeni se korrespondenca e dërguar nga burgu ishte bashkuar me dosjen përkatëse të hetimit penal lidhur me kallëzimet ndaj personave në fjalë, pa u kryer ndonjë veprim hetimor në lidhje me pretendimet e keqtrajtimin (siç është marrja e një deklaratë ose kërkimi i një ekzaminimi mjeko-ligjor). Kur u pyet për një shpjegim në lidhje me këtë gjendje, prokurori u shpreh se, sipas mendimit të tij, nuk kishte pasur prova të pamjaftueshme për të hapur një hetim penal për pretendimet e keqtrajtimin të policisë.

Sipas mendimit të CPT, mungesa totale e veprimit hetimor nga prokurori në dritën e pretendimeve konkrete për keqtrajtim të policisë, të cilat u mbështetën edhe me prova mjekësore (nga burgu), është e pajustificuar.

CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të ofruar trajnime për prokurorët përkatës në mënyrë që të sigurohet që:

- Ankesat dhe informacionet e tjera për keqtrajtime të policisë të hetohen në mënyrë efektive;

- Sa herë që prokurorët të marrin ankesa ose informacione të tjera treguese për keqtrajtim të policisë, të urdhërohet menjëherë një ekzaminim mjeko-ligjor.

17. Në përgjithësi, CPT ka vërejtje për faktin se shqyrtimi i pretendimeve për keqtrajtim të policisë i kishte kaluar të njëjtit prokuror që ishte përgjegjës për hetimin penal kundër personit, i cili pretendohet se është keqtrajtuar. Sipas prokurorit, i cili u takua nga delegacioni, kjo ishte praktikë normale në sistemin gjyqësor shqiptar.

Sipas mendimit të CPT-së, një përgjegjësi e tillë e dyfishtë mund të çënojë paanshmërinë e prokurorit në fjalë. Prandaj, **Komiteti rekomandon që rastet e keqtrajtimin të mundshëm të policisë të hetohen nga prokurorë të cilët nuk kanë lidhje me hetimet penale kundër viktimave të pretenduara të keqtrajtuara.**

Sipas informacioneve tona, rezulton se ky raport është përcjellë në institucionin tuaj me letërporosi që në vitin 2020<sup>1</sup> dhe do duhet të kishte një reflektim pozitiv në vijimësi në zbatimin e rekomandimeve përkatëse.

Në rastet e trajtuara institucioni ynë ka bërë sugjerimet përkatëse drejtuar organeve të prokurorisë për ndarjen e këtyre procedimeve më vete dhe hetimin e tyre nga prokurorë të ndryshëm. Ka patur raste që nga organet e prokurorisë është reaguuar dhe janë zbatuar detyrat/rekomandimet e CPT-së të cituara më sipër. Ndërkohë ka pasur edhe organe që nuk kanë reaguuar ndaj sugjerimeve të bëra nga institucioni ynë. Në të tilla situata, nga ana

---

<sup>1</sup> Për më tepër, shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> "Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020). Përgjigjja e qeverisë Shqiptare është dërguar në datë 27 Shkurt 2020.

jonë janë bërë rekomandime<sup>2</sup> konform nenit 60/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 21/b të ligjit “Për Avokatin e Popullit” nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar. Deri më tani na është kthyer përgjigje nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, e cila e ka pranuar rekomandimin tonë, dhe jemi në pritje të qëndrimit dhe kthimit të përgjigjes nga Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

2. Një shqetësim jo i vogël, i prezantuar në ankesat e qytetarëve lidhet me çështjet kur ata kanë bërë kallëzime për vepra penale të kryera në dëm të tyre në organet e prokurorisë (drejtëpërdrejtë ose në organet e Policisë së Shtetit, dhe këta të fundit i kanë referuar në organet e prokurorisë), por ndonëse kanë kaluar disa muaj dhe madje edhe disa vite, ata nuk kanë marrë asnjë njoftim se çfarë është bërë me hetimin e kallëzimeve të tyre. Megjithëse ankuesit, persona fizikë e juridikë, në kallëzimet e bëra kanë dhënë adresat banimit apo punës, adresat elektronike, si dhe numrat e telefonëve, nuk kanë marrë njoftime me asnjë prej formave të komunikimit (as në rrugë postare, as në rrugë elektronike dhe as nëpërmjet telefonit).

Nga korrespondenca që kemi pasur me organet e prokurorisë lidhur me këto ankesa, jemi informuar se në disa raste është vendosur mosfillimi i procedimeve penale apo pushimi i tyre për shkaqe ligjore. Ndërsa informacioni i kërkuar lidhur me mos njoftimin e kallëzuesve/viktimave, nuk na është dhënë. Ndërkohë nga kopjet e dokumentacionit të dërguar nga organet e prokurorisë kemi konstatuar edhe raste që njoftimi i tyre ndodhet në dosjen penale, por nuk ka dokument/dëftesë komunikimi që të provojë se është bërë realisht njoftimi/komunikimi i vendimeve në fjalë. Pra, në këto raste në vlerësimin tonë njoftimi është bërë formal dhe për të plotësuar dosjen, por pa efektivitet lidhur me realizimin e të drejtave të shtetasve (kallëzuesve/viktimave të veprave penale) të

---

<sup>2</sup> Në muajin dhjetor të vitit 2022 u kemi dërguar rekomandime Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

parashikuara nga Kodi Procedurës Penale konkretisht neni 9/a<sup>3</sup>, neni 58<sup>4</sup>, neni 326 pika 3<sup>5</sup> dhe neni 329/a pika 4<sup>6</sup>.

**<sup>3</sup> Neni 9/a “Të drejtat e viktimës nga vepra penale”, parashikon se:**

1. Gjatë procedimit penal, viktimat ka të drejtat e parashikuara nga ky Kod.
2. Organet publike duhet të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga ky Kod.

**<sup>4</sup> Neni 58 “Të drejtat e viktimës së veprës penale”, parashikon se:**

**1. Viktima e veprës penale ka të drejtë:**

- a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
  - b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
  - c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;
  - ç) të zgjedhë mbrojtësin dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;
  - d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;
  - dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të tjera përpara organit procedues;
  - e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
  - ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;
  - f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
  - g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
  - gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
  - h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
  - i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;
  - j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.
2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.
  3. Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.
  4. Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j”, të paragrafit 1, të këtij neni. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

**<sup>5</sup> Neni 326 “Pezullimi i hetimeve” parashikon se:**

3. Vendimi i arsyetuar i njoftohet viktimës ose personit që ka bërë kallëzimin, të cilët mund të bëjnë ankim brenda 10 ditëve nga marrja dijani para gjyqtarit të seancës paraprake. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve. Kundër vendimit nuk lejohet ankim.

**<sup>6</sup> Neni 329/a “Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes” parashikon se:**

1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.
2. Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq.
3. Kërkesës së prokurorit i bashkëlidhen aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke përfshirë edhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër.

Evidentojmë faktin se, nëpërmjet analizës dhe argumentimit në këtë rekomandim, nuk synojmë të vlerësojmë e ndikojmë në vendimmarrjen e prokurorëve të çështjeve, pasi është e qartë se kompetente për shqyrtimin e bazueshmërisë ligjore së këtyre vendimeve është gjykata. Por në rastet e moszbatimit të detyrimeve ligjore të prokurorëve lidhur me të drejtat e kallëzuesve dhe viktimave në procesin penal, të garantuara nga Kodi i Procedurës Penale, nuk mund të qëndrojmë indiferentë. Pra, kallëzuesit dhe viktimës së veprës penale duhet t'u garantohen/realizohen në fakt të drejtat e parashikuara në nenin 58, pika 1 dhe për rastin në fjalë të drejtat e parashikuara në gërmat “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, në nenin 326 pika 3 dhe nenin 329/a pika 4.

Por gjithashtu ajo çka është më e rëndësishme në këtë problematikë qëndron në faktin se, duke mos u dhënë informacion apo bërë njoftim kallëzuesve/viktimave të veprës penale lidhur me vendimin e marrë nga prokurorët në rastet e mos fillimit të procedimit penal dhe të pushimit të procedimit penal të kryera për rastet e kundërvajtjeve penale, ata nuk mund të ushtrojnë as të drejtën ligjore të ankimit në gjykatë ndaj këtyre vendimeve.

**3. Një mori çështjesh të regjistruara në institucionin tonë adresojnë cenimin e të drejtës së qytetarëve për t'u informuar nga organet e prokurorisë. Konkretisht, ka pasur raste që qytetarët kallëzues i janë drejtuar me kërkesë për informacion organeve të prokurorisë për veprimet procedurale që janë kryer lidhur me kallëzimet e bëra në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale kur kanë marrë dijeni për veprat penale të kryera, apo se në cilën fazë ndodhen hetimet, por nuk u jepet përgjigje. Sjellim në vëmendje se kërkesa e ankuesve kur ata janë njëkohësisht kallëzues dhe viktimë e veprës penale parashikohet në nenet 58/1/e, 326 pika 3 dhe 329/a pika 4 të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në rastet e tjera kur ata janë kallëzues të një veprë penale të kryer jo ndaj tyre për të cilën kanë marrë dijeni, e drejta për të kërkuar informacion bazohet në nenin 326 pika 3 dhe nenin 329/a pika 4 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu kjo e drejtë bazohet në nenin 23, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar<sup>7</sup>, në nenin 10, pika 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut<sup>8</sup>, si dhe në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, respektivisht në nenet 1, 2/1/a, 3<sup>9</sup>.**

---

*4. Kërkesa i njoftohet të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim. Ata kanë të drejtë të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre.*

<sup>7</sup> **Neni 21 parashikon se:**

*“1. E drejta e informimit është e garantuar”.*

<sup>8</sup> **Neni 10 parashikon se:**

*“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë .....*

<sup>9</sup> **Neni 1 “Objekti dhe qëllimi” parashikon se:**

*1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.  
2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë.*

Ndërkohë theksojmë se në nenin 15<sup>10</sup> të këtij ligji është parashikuar edhe afati për marrjen e informacionit të kërkuar, ndërsa në nenet 18 e 19 të tij parashikohen kundërvajtjet administrative dhe sanksionet, si dhe përgjegjësia administrative për mosrespektimin e dispozitave të këtij ligji.

Qëndrimet mosvepruese të strukturave të organeve të Prokurorisë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para lidhur me problematikat e konstatuara nga institucioni ynë, jo vetëm që nuk janë në përputhje me aktet normative në fuqi të cituara më sipër, por njëkohësisht çënojnë edhe besimin publik të këtij organi.

**4.** Përveç problematikave të parashtruara më sipër, çojmë të ndajmë me ju edhe një shqetësim të evidentuar lidhur me mos kthimin e përgjigjeve dhe informacioneve të kërkuara nga ana jonë në kuadër të hetimit administrativ për trajtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të prokurorisë. Nga disa prej këtyre strukturave nuk na kthehen përgjigje ose ato na kthehen me vonesë dhe pas dërgimit të disa kërkesave të përsëritura.

---

*3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.*

**Neni 2 “Përkufizime” parashikon se:**

*Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:*

*1. “Autoritet publik”:*

*a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; ....*

*2. “Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik....*

**Neni 3 “E drejta e informimit” parashikon se:**

*“1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.*

*2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.*

*3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.*

*4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji”.*

<sup>10</sup> **Neni 15 “Afati për marrjen e informacionit” parashikon se:**

*“1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.*

*2. Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.*

*3. Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme:*

*a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;*

*b) nevoja për t’i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;*

*c) nevoja për t’u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës. Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuarit.*

*4. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.*

*5. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji”.*

Ky qëndrim në vlerësimin tonë nuk është korrekt dhe sjell si pasojë zvarritje dhe vonesa në afate të shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave të shtetasve nga institucioni ynë. Për rrjedhojë, kjo sjell edhe cënimin e reputacionit të Avokatit të Popullit në publik.

Jemi të vetëdijshëm mbi situatën e krijuar tashmë në organet e prokurorisë për shkak të ngarkesës së lartë<sup>11</sup>, pas largimit të një numri të konsiderueshëm të prokurorëve për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Por, pavarësisht kësaj gjendjeje nuk mund të pajtohemi me qëndrimin mosveprues të këtyre strukturave publike ndaj kërkesave të institucionit tonë. Ndaj kërkojmë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj që të mos ketë pengesa në realizimin e misionit kushtetues e ligjor të institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme ose të parregullta të organeve të administratës publike.

Avokati i Popullit vlerëson se çështje të tilla ndikojnë tek besimi i publikut në organin e akuzës çka përbën një shqetësim madhor të shtetasit e shoqërisë shqiptare ndaj lind nevoja të adresojmë këto problematika.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, vlerëson se, bazuar në evidentimin e problematikave të lartpërmendura, si dhe për të garantuar respektimin me korrektesë, objektivitet, paanshmëri e profesionalizëm të rregullave dhe parimeve procedurale gjatë hetimit të procedimit penal, domosdoshmërisht lind nevoja e një reagimi nga ana juaj për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve nga organet e prokurorisë gjatë procesit penal në përputhje me legjislacionin procedural penal në fuqi, rekomandimet e CPT-së dhe ligjin “Për të drejtën e informimit”. Këtë vlerësim e mbështesim edhe duke iu referuar nenit 1 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: *“Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit.”*

Për sa më sipër dhe me qëllim rritjen e performancës dhe besimit publik të organeve të prokurorisë në të ardhmen, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet

---

<sup>11</sup> Sipas Raportit të Komisionit European për Shqipërinë, publikuar në 12.10.2022, Shqipëria në vitin 2021 ka pasur 300 prokurorë me kohë të plotë (10.5 për 100,000 banorë). Sipas Komisionit European për Efiçencën në Drejtësi (CEPEJ), mesatarja evropiane është 12 prokurorë për 100,000 banorë.

Për më tepër shih linkun si vijon:

[https://ec.europa.eu/info/departments/european-neighbourhood-policy-and-enlargement-negotiations\\_en](https://ec.europa.eu/info/departments/european-neighbourhood-policy-and-enlargement-negotiations_en)



se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në gërmën “c” të nenit 21 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen;

### **REKOMANDIMË :**

Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen, miratimin dhe dërgimin organeve të prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm të një udhëzimi/qarkoreje për përmirësimin e punës së tyre për respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve gjatë procesit penal lidhur me problematikat e parashtruara më sipër.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda Ballanca**

Konceptoi: S. Nushi

Miratoi: E. Ruspi